



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 144/1 Prot.

Vlorë më, 25. 01. 2021

VENDIM

Nr. 5, datë 21. 01. 2021

PËR  
KRITERET DHE PROCEDURËN E PËRZGJEDHJES SË ADMINISTRATORIT TË  
UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË

Në zbatim të neneve 49 pika 1, gërma f dhe neni 51 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neneve 25 pika 1, gërma f dhe 40 pika 2, të Statutit të UV- së, në mbledhjen e datës 21. 01. 2021 Bordi i Administrimit:

VENDOSI

1. Të miratojë si kriteret për punësimin e Administratorit të UV-së si më poshtë:  
Administratori i Universitetit duhet:
  1. Të jetë shtetas shqiptar;
  2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
  3. Të jetë i aftë nga ana shëndetësore;
  4. Të ketë arsim të lartë, së paku në nivelin "Master i Shkencave", në fushën e drejtësisë ose të ekonomisë dhe përvojë pune së paku 7 (shtatë) vjet në këto fusha;
  5. Të njoh të paktën 1 (një) gjuhë të huaj (anglisht);
  6. Të ketë përvojë pune në Institucionet e Arsimit të Lartë ose në fushën e administrimit publik apo financiar ose mësimdhënies;
  7. Të mos jetë i dënuar më parë me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e ndonjë krimi;
  8. Të mos jenë marrë ndaj tij masa disiplinore të largimit nga administrata shtetërore, e cila nuk është shuar sipas ligjit;
  9. Të ketë vlerësime pozitive të përvojave të mëparshme të punës;
  10. Të ketë aftësi komunikimi, bashkëpunimi dhe menaxhimi për të zgjidhur çështjet me efikasitet.

Dokumentet që duhet të shoqërojnë kërkesën:

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele  
Tel. Fax ++355222288

web-site: www.univlora.edu.al  
e-mail: info@univlora.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

1. Fotokopje të kartës së identitetit;
2. Një kopje të jetëshkrimit (CV);
3. Kopje të noterizuar e diplomës/ diplomave dhe/ose njehsimin e tyre në MASR (për diplomat e marra jashtë vendit), bashkë me listën e notave të noterizuara (për të dy ciklet e studimit);
4. Kopje të librezës së punës;
5. Vërtetim i gjendjes gjyqësore, vetë deklaram sipas formës së kërkuar nga ligji;
6. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
7. Vërtetim nga punëdhënës të mëparshëm, që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
8. Certifikatë të kualifikimeve dhe trajnimeve;
9. Dëshmi të njohjes së gjuhës së huaj, sipas testeve ndërkombëtare;
10. Referenca nga punëdhënës të mëparshëm, që provojnë vlerësimet pozitive në punë.

2. Të interesuarit duhet të dërgojnë me postë dokumentacionin përkatës, në adresën :

Universiteti "Ismail Qemali"  
Rektorati  
L. Pavarësia, Rr. Kosova  
9400 Vlorë, Shqipëri

3. Nuk lejohet paraqitja e dokumentacionit dorazi.

4. Ngakohet Drejtoria e Komunikimit dhe e Burimeve Njerëzore të bëj shpalljen dhe ndjekjen e afateve sipas legjislacionit në fuqi, për konkurim të hapur për pozicionin e Administratorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

5. Çdo vendim i mëparshëm në lidhje me kriteret e punësimit të Administratorit të UV-së shfuqizohet.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Dr. Ervis Mocka**

1. Anjeza Shiko- Anëtar

2. Rajmonda Sinoimeri- Anëtar

3. Enida Pulaj- Anëtar

4. Marinela Muço- Anëtar

5. Elsajed Rexhaj- Anëtar

6. Enrik Mehmeti- Anëtar

